



Tiranë, më 31 Janar 2019

### Thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në workshop-in me tematikë

#### MASAT E DREJTËSISË RESTAURUESE DHE NDËRMJETËSIMI PËR TË MITURIT

Misioni i Terre des hommes Shqipëri, në bashkëpunim me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Dhomen Kombëtare të Ndërmjetësve **ftojnë ndërmjetës të licencuar të shprehin interesin për të marrë pjesë në workshopin dy-ditor mbi “Masat e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin për të miturit”.**

Aktiviteti organizohet në Tiranë në datat **20-21 Shkurt 2019**, si pjesë e projektit “Aktivizimi i shoqërisë civile në modelimin e praktikave restauruese për fëmijët dhe të rinjtë në kontakt me ligjin”, i financuar nga Bashkimi Evropian (EIDHR).

Qëllimi i workshop-it është njohja me parashikimet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit në lidhje me shmangien nga procesi penal dhe referimin në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, dhe rritja e kapaciteteve dhe aftësive ndërmjetësuese dhe lehtësuese të pjesëmarrësve, veçanërisht në trajtimin e rasteve ku janë të përfshirë të mitur në kontakt me ligjin.

Në workshop do të marrin pjesë rreth 20 ndërmjetës të licencuar (me licencë aktive) nga rrethet Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë, ku dhe zbatohet projekti (do përzgjidhen 3-4 ndërmjetës/rreth)

Të interesuarit janë të lutur **të paraqesin kërkesën e tyre nëpërmjet email-it, duke shpjeguar motivimin për të marrë pjesë**, në adresën [mediation@afcr.al](mailto:mediation@afcr.al) (cc: [info@tdhalbania.org](mailto:info@tdhalbania.org); [info@dhkn.gov.al](mailto:info@dhkn.gov.al)) brenda datës **13 shkurt 2019**.

Personat e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës **15 Shkurt 2019**.

#### Call for Expression of Interest to attend the workshop on

#### RESTORATIVE JUSTICE MEASURES AND MEDIATION FOR JUVENILES

Terre des hommes Mission in Albania, in partnership with the Foundation for Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes and the National Chamber of Mediators **invite licensed mediators to express their interest in attending a two-day training workshop on “Restorative justice measures and mediation for juveniles”.**

The workshop will be held in Tirana, on **20-21 February 2019**, as part of the project on “Civil society in action to build restorative approaches and practices for children & youth in conflict or contact with the law”, financed by the EU Delegation in Albania (EIDHR).

The goal of the workshop is to introduce the trainees with the provisions of the Code for Criminal Justice for Minors with regard to application of diversion of juveniles to restorative justice programs and mediation, as well as to increase the mediation and facilitation skills of the participants, particularly in managing cases involving juveniles in contact with the law.

The workshop is designed for 20 participants, licensed mediators (active license) from Tirana, Shkodra, Durresi, Vlora, Korça and Gjirokastra, as they are the project targeted area (3-4 mediators/district).

The interested persons are advised to submit a Letter of Interest, expressing their motivation to attend, to the following email address: [mediation@afcr.al](mailto:mediation@afcr.al) (cc: [info@tdhalbania.org](mailto:info@tdhalbania.org), [info@dhkn.gov.al](mailto:info@dhkn.gov.al)) **by 13 February 2019**.

The selected persons will be notified within **15 February 2019**.